

Mos e humbni këtë informacion.
Këtë informacion ia tregoni mjekut apo infermieres.

Tiedote tuberkuloosista: albania

Informacion për tuberkulozin dhe kontrollat e tuberkulozit

Pse ju është dhënë ky informacion?

Në Finlandë tuberkulozi është sëmundje e rrallë. Me mjekim të mirë gadi se është zhdukur fare. Vini nga shteti ku ka të sëmuar nga tuberkulozi. Mund ta bartni sëmundjen dhe ta shpërndani tuberkulozën në afërsinë e juaj pa e ditur fare. Për shkak të shëndetit të juaj, të të afërmeve të juaj si dhe të tjerëve rreth jush është me rëndësi që sëmundja eventuale e tuberkulozës të vërehet dhe të mjekohet me kohë.

Në Finlandë dëshirojmë që të kujdesemi për shëndetin e imigrantëve. Me që mendoni të qëndroni në Finlandë mbi tre muaj, atëherë keni të drejtë të shkoni falas në inçizim të mushkrive. Inçizimi bëhet vetëm nëse dëshironi vullnetarisht. Me inçizim të mushkrive sqarohet se a keni ndryshime tuberkuloze në mushkri.

Inçizimi i mushkrive

Tuberkulozi i mushkrive më shpesh diktohet në inçizimin rentgenik të mushkrive. Inçizimi është i padëmshëm. Shtatzënet, para inçizimit, duhet të tregojnë për gjendjen e tyre. Inçizimi i mushkrive të shtatzënës që nuk kan simptome të sëmundjes bëhet në fazën e fundit të shtatzënisë.

Inçizimi i mushkrive bëhet në shtëpinë e shëndetit të vendbanimit të juaj. Për Ju inçizimi është pa pagesë. Nëse në inçizim ka ndryshime, atëherë do të kontaktojmë me Ju dhe të organizojmë egzaminimet tjera.

Lajmërohuni sa më shpejtë për inçizim të mushkrive!

Këtë informacion ia tregoni infermieres te shtëpia e shëndetit apo te rentgeni.

Kontakt-shenimet e shtëpisë së shëndetit/rentgenit: _____

Cilat janë simptomet e tuberkulozit?

Simptomi më i rëndësishëm i tuberkulozit të mushkrive është kolli i gjatë, koll që zgjatë mbi tre javë që me kohë mund të shëndrohet në koll me këlbazë. Me sulmin e kollit mund të pështyeni këlbazë në ngjyrë të verdhë, të kaftë apo me gjak. Me zhvillimin e sëmundjes mund të keni vështërsi në frymëmarrje apo dhëmbje të gjoksit.

I sëmuari nga tuberkulozi mund të ketë temperaturë, të humb peshë dhe natën të ndjersitet shumë. Oreksi dhe kondicioni mund t'i dobësohen. Mund të ketë edhe simptome tjera varësisht se cila pjesë e trupit është sëmurë.

Te fëmijët tuberkulozi shkakton ngadalsim/ngecje në rritje dhe zhvillim.

Çfarë duhet të bëni nëse keni simptome që i ngjajnë tuberkulozit apo nëse ato lajmërohen më vonë?

Kontaktoni pa vonesë me shtëpinë e shëndetit në vendbanimin e juaj. Është i domosdoshëm kontrolli mjeksor. Për ju kontrolli mjeksor është falas. Të dhënat e egzaminimit nuk i lajmërohen zyrës imigracionit.

Ç`është tuberkulozi?

Tuberkulozi nuk është faji i askujt. Tuberkulozi është sëmundje ngjitëse. Sëmundjen e shkakton bakterja *Mycobacterium tuberculosis*. Tuberkulozi më së shpeshti lajmërohet në mushkri ku formohet vatër e infektimit. Nga aty bakterjet mund të shpërndahen në pjesë tjera të trupit përmes gjakut apo fluidit limfatik si p.sh. në gjendrat limfatike, në zorët, në lëkurë apo sistemin qendror nervor. Tuberkulozi mund të jetë njëkohësisht si në mushkri ashtu dhe në pjesë tjera të organizmit.

Si ngjitet tuberkulozi?

Tuberkulozi ngjitet përmes ajrit nga njeriu në tjetrin. Bakterje të tuberkulozit shpërndahen në ajër kur ai/ajo që ka sëmundjen e tuberkulozit në mushkri flet, këndon, kollitet apo teshtitë. Me atë rast personi që ndodhet në dhomën e njejtë mund të marrë bakterje në mushkri të veta me ajrin që merr me frymëmarrje. Atëherë ata që kanë qëndruar kohë të gjatë me të sëmurin mund ta marrin sëmundjen. Reziku më i madhë i ngjitjes është te anëtarët e familjes që banojnë së bashku.

Kush sëmuret nga tuberkulozi?

Nga ata që marrin ngjitje të pjesërishtme të tuberkulozit, vetëm një ndër dhjetë sëmuren nga tuberkulozi. Më lehtë sëmuren të vegjlit, fëmijët nën moshën 5-vjeçare, të rinjtë e moshës së re madhore, të moshuarit dhe ata që kanë imunitet të dobësuar.

Sa shpejtë ngjitja e tuberkulozit shëndrohet në sëmundje?

Fëmiju i vogël nën moshën 5-vjeçare i pavaksinuar mund të sëmuret disa javë apo një muaj pas ngjitjes dhe sëmundja mund të përparon shpejtë. I rrituri që nuk ka ndonjë sëmundje themelore, zakonisht sëmuret brenda një apo dy vitesh nga ngjitja. Nga tuberkulozi mund të sëmuret edhe brenda dhjetë vitesh nga ngjitja. Mбай mend simptomat e tuberkulozit.

Ki dhe si kontrollohet tuberkulozi?

Egzaminimet fillohen në shtëpinë e shëndetit, në kujdesin për shëndetin nëpër vendshkollime apo në mjeksinë e punës. Egzaminimet vazhduese bëhen në spital. Fëmijët kontrollohen në repartin ose në poliklinikën e pediatrikë. Tuberkulozi i mushkrive te të rriturit kontrollohet dhe mjekohet në repartin ose në poliklinikën e sëmundjeve të mushkrive të spitaleve.

Nëse dyshohet në tuberkulozin e mushkrive, bëhet inçizimi i mushkrive dhe egzaminohen mostrat e pështymës. Nga mostrat e pështymës bëhen ngjyrosjet dhe kulturozhvillimi për tuberkuloz. Nga pështyma sipas nevojës mund të bëhet testim i shpejtë që tregon genin e tuberkulozit.

Ndonjëherë duhet të bëhet endoskopi bronkiale apo inçizim shtresor të mushkrive. Kur tuberkulozi kontrollohet në vende tjera pos mushkrive, përdoren metoda të ndryshme inçizuese. Poashtu tentohet të mirren mostra të indit ose mostra tjera nga organi i sëmuar.

Si mjekohet tuberkulozi?

Tuberkulozi mjekohet me ilaçe. Në fillim ka së paku katër ilaçe. Mjekimi i tuberkulozit të rëndomtë zgjatë së paku gjysëm viti. Nga tuberkulozi shërohen mirë nëse tuberkulozi vërehet me kohë dhe mjekimi zgjatë sa duhet. Mjekimi i tuberkulozit në Finlandë është i mirë dhe falas.

Lexo më tepër për tuberkulozin: www.tuberkuloosi.fi